

LIGJ
Nr. 37/2019

**PËR DISA SHTESA NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 4,
DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN DHE
DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE
SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA,
MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE”, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 9967, DATË 24.7.2008, DHE
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 3/2015**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, dhe ndryshuar me ligjin nr. 3/2015, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në paragrafin e dytë, në fjalinë e parë, pas fjalës “tenderit” shtohen fjalët “ose tjetërsimit, sipas veprimeve juridike të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përveç formës së kalimit të pronësisë nëpërmjet kontratës së dhurimit.”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Kalimi i pronës shtetërore në private të bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore, me kushtin që pjesa shtetërore të mos jetë më e madhe se 20 për qind e pronës që do të zhvillohet, sipas kushteve dhe kriterëve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave, për këto raste, përcakton, gjithashtu, kushtet që duhet të plotësojnë kërkuesit e tjetërsimit me kontratë të pronës shtetërore, mënyrën e vlerësimit të pronës shtetërore, si dhe organet që përfshihen gjatë procesit dhe rolin e tyre.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.6.2019